**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJGJEVE PËR VITIN 2025**

Periudha (janar 2025)

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 01 | 06.01.2025 | Sa është numri i lejeve të ndërtimit të dhëna nga Bashkia për vitet 2022-2024? | 07.01.2025 | -Viti 2022 – 29 leje ndërtimi<br>-Viti 2023 – 28 leje ndërtimi<br>-Viti 2024 – 19 leje ndërtimi | E plotë | Pa pagesë |
| 02 | 06.01.2025 | 1.Disponueshmerinë e alternativave fizike për shërbimet publike që janë ofruar për të moshuarit që nuk kanë akses në platforma dixhitale.<br>2.Politikat dhe nismat e ndërmarra nga institucionet tuaja për përfshirjen dhe edukimin dixhital të të moshuarve.<br>3.Çdo informacion tjetër që vlerësoni të dobishëm. | 07.01.2025 | 1.Përsa i përket disponueshmërisë së alternativave fizike për shërbimet publike, për të moshuarit që nuk kanë akses në platformat dixhitale shërbime fizike mund të kryhen vetem pranë zyrës së One Stop Shop, por vetëm shërbime të kërkesë-ankesave për ndonjë problematikë të caktuar.<br>2.Bashkia Belsh si një bashki e vogël dhe dhe në mungesë të fondeve të mjaftueshme, nuk ka politika të hartuara apo nisma të ndërmarra për përfshirjen dhe edukimin dixhital të të moshuarve. | E plotë | Pa pagesë |
| 03 | 22.01.2025 | Kërkesë për informacion mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe | 27.01.2025 | Gjatë vitit 2024, Bashkia Belsh ka ndërmarrë hapa për promovimin e dialogut ndërkulturor dhe përfshirjes sociale të komunitetit Egjiptian. | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Egjiptianëve 2021-2025? | | Janë organizuar aktivitete sensibilizuese në bashkëpunim me shkollat dhe institucionet lokale, që kanë synuar edukimin e fëmijëve dhe të rinjve mbi barazinë dhe bashkëjetesën sociale. Përveç kësaj, janë zhvilluar takime me përfaqësues të komunitetit për të evidentuar dhe adresuar nevojat dhe sfidat e tyre në fusha si arsimi, shëndetësia dhe punësimi.Gjithashtu, duke u konsultuar me zyrat përkatëse në Bashkinë Belsh, përsa i përket fushave kryesore që përfshin Plani Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, na janë dhënë informacionet si më poshtë:<br>-Gjatë vitit 2024, nuk janë evidentuar individë të paregjistruar në gjendjen civile nga komuniteti Egjiptian.<br>-Të gjithë fëmijët e këtij komuniteti kanë vazhduar dhe përfunduar arsimin gjatë vitit 2024. Gjithashtu, në institucionet parashkollore janë regjistruar dy fëmijë të komunitetit egjiptian. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | -Sipas të dhënave nga Zyra e Burimeve Njerëzore, gjatë vitit 2024 nuk ka pasur punësime të reja nga komuniteti Egjiptian, përveç atyre të punësuar më parë.<br>-Dy familje të komunitetit egjiptian kanë përfituar ndihmë ekonomike gjatë vitit 2024.<br>-Ky informacion është përgatitur në përputhje me kërkesat e përcaktuara dhe me udhëzimet metodologjike për raportimin nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës. | | |